



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS – SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-23650/23 datë: 25.08.2023



Npi – 01/308 datë: 29.08.2023

Duke u bazuar në nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 29.08.2023, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I M B L E D H J E S S Ë - V I I I - T Ë K O M I T E T I T P Ë R K O M U N I T E T E
E mbajtur më: 29.08.2023 (e martë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë, Kryesuesi, z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri, znj.Shkurte Mustafa, dhe znj.Shkurte Behluli. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: z.Bujar Ferati ZKF dhe Praktikantja znj.Sadbere Halili.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Bajram Ilazi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 25.04.2023, 23.06.2023, 04.07.2023,
2. Raporti buxhetor për gjashtëmuajorin e parë Janar-Qershor 2023,
3. Propozim-Vendim për faljen e 100 euro nga tatimi në pronë, bazuar në Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.08/L-224 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme,
4. Prezantimi i Planit Buxhetor 2024-2026,
5. Propozim-Vendim për rialokimin e mjeteve,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për rendin e ditës.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 25.04.2023, 23.06.2023, 04.07.2023

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt Procesverbalet me datë 25.04.2023, 23.06.2023 dhe 04.07.2023 .**

Pika 2

Raporti buxhetor për gjashtëmujorin e parë Janar-Qershor 2023

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Raportin buxhetor ne e kemi për obligim ligjor për ta prezantuar në Kuvend. Materialin e raportit e kemi marrë dhe e kemi lexuar buxheti është mbi 8 milion. Të hyrat janë detajizuar në faqen e 4 të dokumentit. Në vazhdim i spjegoi me shifra të ndara në kategori ekonomike për secilin shpenzim (shih dokumentin).

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, faleminderit për raportin, unë e kam lexuar, kemi rritje të hyrave që duhet me u mburrë, kam një pyetje se pse nuk janë shpenzuar mjetet e Donacionit nga “VORAE” ?

z.Bujar Ferati, ZKF; Zyra e tatimit në pronë është duke shkuar mirë me punë. Sa i përket “VORAE” d.m.th. ata e kanë mbyllë projektin, por edhe ne po ashtu e kemi mbyllur, dhe disa mjete kanë mbetur nga viti i kaluar diçka mbi 1 mijë euro, dhe ne duhet të shohim rrugën ligjore se çka mundemi me bërë me këto mjete.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Meqenëse unë punoj në këtë OJQ-ë “VORAE” stafi janë në diskutim e sipër se si do të veprojmë që edhe këto mjete me u shpenzuar. Buxheti në disa linja është shpenzuar vetem 30% si do të shkoj kjo a do ti kthehen mjetet Qeveris apo si shkon?

z.Bujar Ferati, ZKF; Për shpenzimet janë të obliguar me i kryer drejtorit. Unë vetem i marrë shumat si raportim, prandaj ata e kanë përgjegjësinë për shëpenzimin e tyre.

z.Besnik Seferi; Sa ka realizim të shpenzimeve të projekteve kapitale?

z.Bujar Ferati, ZKF; Këtu kemi 24.25%, ku do të thot se puna u kry nga operatori sipas kontratës dhe paratë janë marrë.

Pika 3

Propozim-Vendim për faljen e 100 euro nga tatimi në pronë, bazuar në Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.08/L-224 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; 15 shtatori është data e fundit ku Kuvendi mundet me marrë vendim për faljen e 100 euro të tatim paguesëve.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Sa është rritja që u është bërë qytetarëve për tatimin në pronë edhe a lidhet kjo me faljen e 100 eurove.

z.Bujar Ferati, ZKF; Kjo është temë tjetër e rritjes dhe nuk mundem me fol me shifra prandaj nuk po lëshohem më tutje.

z.Besnik Seferi; Unë jamë plotësisht për që ta miratojmë Vendimin për faljen e 100 eurove.

***Komiteti për Komunitete, me 6 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstënim” vendosi t’i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për faljen e 100 eurove nga tatimi në pronë, bazuar në Ligjin për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.08/L-224 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.**

Pika 4

Prezantimi i Planit Buxhetor 2024-2026

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Sqaroi se sipas ligjit ky plan buxhetor do të shkojë në diskutim publik dhe aty do të keni mundësinë që të jepni kontributin e juaj. Ne kemi bërë vetëm disa dallime në krahasim me buxhetin e kaluar.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Ne kemi bërë 4-5 kërkesa e nuk janë inkorporuar. Tash prapë në diskutim publik nuk po kuptojë.

z.Bujar Ferati, ZKF; Unë thash se përgjigjem vetëm për pjeën time të përgjegjësis, ndërsa drejtorat i kanë përgjigjësit e tyre.

z.Besnik Seferi; Ky Plan Buxhetor do të shkojë në diskutim publik, ne kemi bërë disa rekomandime për Kuvendin, por ne kemi me kërkuar prapë që me u futë projektet që i propozon Komiteti për Komunitete.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Propozoj që me u taku me Kryetarin dhe me i prezantuar kërkesat tona.

z.Besnik Seferi; Unë mendojë se të paktën pa një përfaqësues të drejtoris ose drejtorin për pikën që e kemi caktuar nuk duhet të diskutojmë ose të merr pjesë vetë drejtori.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi t'i Rekomandoi Kuvendit miratimin e Vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Planin Komunal Buxhetor 2024-2026. Me kërkesën që Zyra për Informim të publikojë sa më shumë informata në publik edhe në rrejetet sociale lidhur me procesin e diskutimit publik të Draft Planit Buxhetor 2024-2026.**

Pika 5

Propozim-Vendim për rialokimin e mjeteve

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Fjalën ja dha z.Bujar Feratit.

z.Bujar Ferati, ZKF; Material nuk kemi dërguar sepse nuk është finalizuar propozim-vendimi, nëse arrin me finalizu e diskutojmë në Kuvend nëse jo e shtyejmë si pikë.

z.Besnik Seferi; Unë nuk e kamë marrë materialin, tash po e kujtojë se nuk ka material për këtë pikë.

Kryesuesi z.Bajram Ilazi; Unë e falenderoj Bujarin për prezantimin.

Pika 6

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.


znj.Rrezartë Ramadani; Përshëndetje, unë javën e kaluar e kam pyetur drejtoreshën e Arsimit a mundet me bë diçka më shumë për regjistrimin e nxënësëve të Komuniteteve meqenëse numri i nxënësëve është i vogël.

z.Muhamet Mehmeti; Përshëndetje, ne i kemi vetëm 4 nxënës të rexhistruar, kaq janë të rexhistruar nuk është se ka të tjerë e nuk jan regjistruar. Për libra kanë mbetë edhe 6 nxënës pa aplikuar. Nuk e di se qysh kemi me mujtë me ju ndihmuar këtyre nxënësve.

Kryesuesi, z.Bajram Ilazi; Edhe Ministria ka kërkuar me i aktivizuar të gjitha potencialet për me ju ndihmuar për aplikim.

Meqenëse diskutime tjera nuk kishte Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:20h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi

